



BASHKIA TIRANË
AGJENCIA E PARQEVE DHE REKREACIONIT

PROJEKT

“NDËRHJRJE REABILITUESE NË

RRUGËT AUTO PYJORE”

L=8793ml

Ekonomia Pyjore “SHESH”

Viti. 2025

➤ Tabela e përmbajtjes

Hyrje.....	5
Qellimi i projektit.....	7
Planifikimi i rjetit rrugor në pyje.....	9
Qasja në shifrat kryesore.....	11
Konceptet e qasjes.....	12
Terreni i rrafshët.....	12
Terreni kodrinor e malor.....	12
Rrugët e luginës.....	13
Rrugët e pjerrëta.....	14
Elementet e rrugëve.....	15
Kthesat.....	16
Vendkalimet në përrerj.....	16
Struktura e sipërme e rrugës.....	16
Menaxhimi i ujit.....	16
Mirëmbajtja.....	17
Qëllimet e mirëmbajtjes së rrugëve pyjore.....	17
Llojet e mirëmbajtjes.....	17
Dallimi në mes të riparimit, mirëmbajtjes dhe përmirësimit.....	18
Parimet e mirëmbajtjes së rrugëve pyjore.....	18
Arsyet e degradimit të rrugëve pyjore.....	19
Shkaktarët mjedisor.....	20
Ndikimet tjera prej mjedisit.....	21
Elementet e mirëmbajtjes.....	22
Drenazhimi i ujit.....	22
Mirëmbajtja e sistemeve të drenazhimit.....	23
Konfigurimi i kanalit kullues.....	24
Sipërfaqja/shtresa e sipërme e rrugës.....	25
Erozioni i rrugës për bartje për shkak të rrjedhës së ujit.....	26
Rruga për bartje e dëmtuar si pasojë e trafikut dhe kamionëve të stërngarkuar.....	26
Bazamenti i rrugës/struktura.....	27
Vegjetacioni.....	27
Punët më të zakonshme të mirëmbajtjes.....	28
Mekalizimi për mirëmbajtje.....	28
Makineria për pastrimin e rrugës për bartje.....	29
Përshkrimi i rrugëve që do rehabilitohen.....	30
Sigurimi i aksesit për menaxhimin e pyjeve.....	31
Përmirësimi i kushteve të transportit të produkteve pyjore.....	31
Ruajtja e biodiversitetit dhe ekosistemit pyjor.....	31
Përmirësimi i sigurisë dhe qasjes për urgjencat.....	31

Lehtësimi i turizmit dhe aktiviteteve rekreative	32
Menaxhimi i erozionit dhe ruajtja e tokës	32
Studimi i terrenit dhe kushteve lokale	32
Ndërhyrja minimale në natyrë	32
Përeaktimi i llojit të rrugës	32
Përdorimi i teknologjive të avancuara	33
Siguria dhe qasja për urgjencat	33
Mbrojtja e mjedisit dhe qëndrueshmëria	33
Mirëmbajtja dhe ndjekja	33
Qëllimi dhe rëndësia e koridoreve të zjarrit:	34
Karakteristikat e koridoreve të zjarrit:	34
Metodat e krijimit dhe menaxhimit të koridoreve të zjarrit	34
Përfitimet e koridoreve të zjarrit	35
Vlerësimi i gjendjes ekzistuese të rrugës	35
Projektimi i rehabilitimit të rrugës	35
Zbatimi i teknologjive të qëndrueshme	36
Përfshirja e aspekteve ekologjike dhe mjedisore	36
Mirëmbajtja e rrugës pas rehabilitimit	37
Përfundim	37
Qasja rampa	37
Qëllimi dhe pozicioni i objekt studimit	37
Harta e infrastruktures	38-40
Rruget /Mbushjet	40
Rrafshimi i sipërfaqes rrugore	41
Pershkrimi i rrugeve që do rehabilitohen	43
Gjendja ekzistuese e segmenteve rrugore	44
Vendndodhja	50
Referenca	51
Preventivi	
Profilat	

Lista e figurave

Figura 1: Prerja tipike e tërthort.....	3
Figura 2: Prerja tipike e tërthort (kthesa)	10
Figura 3: Dijametri për një kthesë, përfshirë gërmimin dhe mbushjen,	10
Figura 4: Gjatësia rrugore dhe densiteti	11
Figura 5: Hapësira rrugore dhe ajo e qasjes	11
Figura 6: Rruga e luginës me kryqëzim në luginën anësore	13
Figura 7: Rruga e luginës me lakore (serpentinë) dhe kryqëzim.....	13
Figura 8: Rrugët e pjerrëta ku pjerrtësia e përroit është shumë e rrëpirët	13
Figura 9: Rjeti rrugor i pyjeve në kushte jostabile të tokës.....	15
Figura 10: Rruga e pjerrët.....	15
Figura 11: Rruga e pjerrët me kryqëzime për të zhvilluar rjetin.....	14
Figura 12: Shembull i keq i zhvillimit të rrugëve të shpatit ndaras.....	15
Figura 13: Shembull i mirë i hapjes së një shpati me distanca të mëdha midis kthesave	15
Figura 15 Hartat e infrastrukturës rrugore ekonomia pyjore SHESH	41
Figura 17 Planimetria e rrugëve ortofoto e gjeoreferuar	41
Figura 18 Planimetria e rrugëve në hartën e pyjeve digjitalizuar dhe gjeoreferuar.....	42
Figura 19 Gjendja e rrugëve në foto.....	42
Figura 21 Planimetria e rrugës në hartën digjitale të gjeoreferuar	500
Figura 22 Foto të gjendjes ekzistuese	50

Lista e Fotografive

Fotografia 2:Kur përfundohen operacionet pyjore, mbetjet duhet të pastrohen	19
Fotografia 4: Anësoret rrugore me pastrim jo të duhur të vegjetacionit (Fotografia: Juri Beguš)	21
Fotografia 5: Reshjet e mëdha, për-dorimi jo i duhur dhe mirëmbajtja e pamjaftueshme/jo e duhur e shkaktojnë erozionin e madh të rrugës për bartje të një rruge pyjore (Fotografia: Juri Beguš).....	21
Fotografia 7: Erozioni sipërfaqësor në terren të rrëpirët (Fotografia: Juri Beguš).....	23
Fotografia 8: Shuangni krijimin e një shtrati me material anash rrugës për bartje	24
Fotografia 9: Vegjetacioni në anën e majtë të fotografisë e bën të pamundur rrafshimin normal	24
Fotografia 10: Pengesat në kanal (Fotografia: Juri Beguš)	24
Fotografia 11: Kanali i tërthorë (Fotografia: Juri Beguš).....	25
Fotografia 12 : Zgjidhjet për problemin në këtë fotografi janë: largimi i vegjetacionit, ndërtimi i një kanali anësor, mbushja e rrugës me zhavorr, rrafshimi dhe formësimi i profilit të kurorës, ngjeshja/presim.....	26
Fotografia 12: Gropat mund të shkaktojnë dëme në automjete.....	26
Fotografia 13 : Vraga e motave në rrugë si rezultat i kamionëve të stërngarkuar që lëvizin në rrugë me sistem jo të duhur drenazhimi dhe me kapacitet bartës të pamjaftueshëm të shtrësës	27
Fotografia 14: Degët e stërvrura duhet të hiqen për të mundësuar që drita e diellit dhe era të depërtojnë në sipërfaqen rrugore në mënyrë që të mundësojnë tharjen e saj	27
Fotografia 15: Kamionët përdoren për të transportuar dhe shpërndarë materialin.....	29
Fotografia 16 : Hapi i fundit i mirëmbajtjes së rrugës është kompaktësimi/ngjeshja.Kjo e rrit jetëgjatësinë e rrugëve pyjore.....	29

Lista e Tabelave

Tabela 1: Shifrat kryesore për modelin e rrjetit rrugor.....

Tabela 2 : Tabela e gjatësisë dhe kordinatat.....

➤ HYRJE

Transferimi i pyjeve në pronësi të Bashkisë sjellë një menaxhim më të përgjegjshëm dhe të qëndrueshëm të këtyre pasurive natyrore, duke kontribuar në zhvillimin e qytetit dhe ruajtjen e mjedisit, zhvillimin e qëndrueshëm dhe përmirësimin e kushteve të jetesës për qytetarët. Ja disa nga përfitimet kryesore:

1. **Menaxhim më i mirë i pyjeve:** Bashkia mund të implementojë strategji të menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve, duke mbajtur një kontroll më të mirë mbi pasurinë natyrore dhe duke ruajtur biodiversitetin e zonave të pyllëzuara.
2. **Përmirësimi i kushteve të ajrit dhe mjedisit:** Pyjet luajnë një rol të rëndësishëm në filtrimin e ajrit dhe rregullimin e temperaturës. Me menaxhimin nga Bashkia, mund të investohet më shumë në ruajtjen dhe zgjerimin e hapësirave të gjelbra.
3. **Zhvillimi i turizmit dhe aktiviteteve rekreative:** Me pyje nën menaxhimin e Bashkisë, mund të zhvillohen projekte për të nxitur turizmin ekologjik, duke krijuar mundësi për aktivitete si ecje në natyrë, kamping, dhe ekskursione.
4. **Ruajtja e biodiversitetit:** Bashkia mund të ndërmarë masa për të ruajtur florën dhe faunën e pyjeve, duke u siguruar që këto ekosisteme të mos dëmtohen nga ndërtimet apo aktivitete të tjera.
5. **Zhvillimi i zonave të gjelbra në qytet:** Duke pasur nën menaxhim pyjet, Bashkia mund të krijojë lidhje më të ngushta mes pyjeve dhe qytetit, duke zhvilluar korridore ekologjike dhe duke përmirësuar cilësinë e jetës për qytetarët.
6. **Rritja e vetëdijes për mjedisin:** Me administrimin e pyjeve nga Bashkia, mund të organizohen fushata për rritjen e ndërgjegjësimit në lidhje me rëndësinë e ruajtjes së mjedisit dhe pyjeve.

Reabilitimi i rrugëve pyjore ekzistuese sjell një sërë përfitimesh për mjedisin dhe komunitetin. Këtu janë disa nga përfitimet kryesore:

1. **Përmirësimi i aksesit dhe sigurisë:** Rrugët e reabilituara lejojnë një qarkullim më të sigurt dhe më të shpejtë, si për punonjësit që punojnë në pyje, ashtu dhe për vizitorët e mundshëm që përdorin ato për aktivitete rekreative. Rrugët më të mira rrisin sigurinë për të gjithë përdoruesit.
2. **Lehtësimi i menaxhimit të pyjeve:** Me rrugë të reabilituara, është më e lehtë për autoritetet dhe punonjësit që të kryejnë aktivitete si mbikëqyrja e pyjeve, mbledhja e druve të rënë, pastrimi i mbetjeve apo zbatimi i masave të ruajtjes së natyrës.
3. **Promovimi i turizmit ekologjik:** Rrugët më të mira mund të tërheqin turistë që duan të vizitojnë pyjet dhe të kryejnë aktivitete si ecje, ecje me biçikletë, ose observim të natyrës. Ky është një mundësi për të zhvilluar turizmin e qëndrueshëm dhe për të kontribuar në ekonominë lokale.
4. **Përmirësimi i mbrojtjes ndaj zjarreve:** Rrugët e reabilituara mund të shërbejnë si linja të mundshme për kalimin e forcave të reagimit në raste zjarresh ose emergjencash, duke mundësuar shpejtësi dhe efikasitet më të lartë në ndërhyrje.
5. **Përmirësimi i aksesit për kërkesa të tjera:** Rrugët mund të përdoren për transportin e materialeve të nevojshme për menaxhimin dhe ruajtjen e pyjeve, si dhe për mbledhjen e burimeve natyrore si druri i prerë (për përdorim të kontrolluar dhe të qëndrueshëm).
6. **Mbrojtja e mjedisit dhe biodiversitetit:** Me rrugët e reabilituara, mund të krijohen mundësi për mbikëqyrje më të mirë të florës dhe faunës, duke siguruar që aktivitetet e njerëzve të bëhen në mënyrë të qëndrueshme dhe pa dëmtuar habitatet natyrore.
7. **Krijimi i mundësive për punësim:** Rregullimi dhe reabilitimi i rrugëve pyjore mund të sjellë mundësi punësimi në komunitetet lokale, duke angazhuar punëtorë për ndihmë në procesin e rinovimit të infrastrukturës.

Reabilitimi i rrugëve pyjore është një investim i rëndësishëm për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe mund të sjellë përfitime të shumta mjedisore, ekonomike dhe sociale.

Reabilitimi i rrugëve pyjore konsiston në procesin e rinovimit dhe përmirësimit të infrastrukturës ekzistuese të rrugëve që kalojnë nëpër zona pyjore. Ky proces përfshin disa hapa dhe aktivitete specifike që ndihmojnë në përmirësimin e aksesit dhe sigurisë, si dhe ruajtjen e ekosistemeve natyrore. Ja disa nga komponentët kryesorë që përfshin reabilitimi i rrugëve pyjore:

1. **Pastrim dhe riparim i rrugëve të dëmtuara:** Pastrimi i rrugëve nga bllokimet e shkaktuara nga pemët e rena, gjethet dhe mbeturinat natyrore. Kjo mund të përfshijë edhe riparimin e dëmeve të shkaktuara nga erozioni ose përmytjet.
2. **Forcimi dhe stabilizimi i shtratit të rrugës:** Përdorimi i materialeve të përshtatshme për të forcuar shtratin e rrugës dhe për të parandaluar erozionin e mëtejshëm. Kjo mund të përfshijë mbushjen e grykave, ndërtimin e mbrojtjeve për lëvizjen e tokës, ose përdorimin e materialeve për të stabilizuar tokën dhe rrugët.
3. **Rregullimi i drenazhimit:** Ndërhijet për të përmirësuar sistemin e drenazhimit të rrugës, duke parandaluar grumbullimin e ujit dhe ndihmuar në shmangien e dëmtimeve të rrugës nga përmytjet.
4. **Krijimi i strukturave mbrojtëse:** Ndërhijet për krijimin e strukturave që mbrojnë rrugën dhe pyllin nga erozioni dhe përmytjet, si ndërtimi i murëve mbajtës, kanaleve të ujit, ose grilave mbrojtëse.
5. **Sistemet e sinjalistikës dhe ndriçimit:** Instalimi i shenjave të qarta për të siguruar që përdoruesit e rrugës (si shëtitës, punonjës pyjesh, ose turistë) të kenë informacion të duhur dhe të mund të udhëhiqen në mënyrë të sigurt.
6. **Kujdesi për ruajtjen e biodiversitetit:** Sigurimi që proceset e reabilitimit të mos dëmtojnë ekosistemet dhe biodiversitetin e zonave pyjore, duke ndihmuar në ruajtjen e habitateve natyrore të florës dhe faunës. Kjo mund të përfshijë edhe masat për kontrollin e erozionit të tokës dhe mbrojtjen e shtretërve të lumenjve afër rrugëve.
7. **Përmirësimi i mundësive për transport dhe akses:** Rrugët pyjore mund të përdoren për transportin e materialeve dhe punën e kërkuar për menaxhimin e pyjeve, si dhe për të mundësuar kalimin e automjeteve të emergjencës (në rast zjarresh, për shembull).

Reabilitimi i rrugëve pyjore është një proces që kërkon planifikim të kujdesshëm dhe ekzekutim teknik, për të siguruar që infrastruktura e përmirësuar të jetë funksionale, e sigurt dhe në harmoni me mjedisin natyror.

Permisimet e parametrave teknike për elementët që përmendni lidhen kryesisht me normat dhe standardet e ndërtimit të infrastrukturës rrugore në zona të ndryshme, duke përfshirë pyje, përrunj, ose terrene kodrinore e malore. Ja disa informacione për secilën nga këto fusha:

1. **Rrugët pyjore:** Parametrat teknikë për ndërtimin e rrugëve pyjore përfshijnë gjerësinë, materialet e përdorura për shtresën e rrugës, dhe mbarëvajtjen e rregullave të ndihmës së mjedisit (për shembull, shmangia e dëmtimit të bimësisë dhe ruajtja e stabilitetit të terrenit). Një element i rëndësishëm është krijimi i rrugëve që nuk dëmtojnë ekosistemet natyrore.
2. **Pjerrësia:** Në ndërtimin e rrugëve malore ose pyjore, përcaktimi i pjerrësisë është kritik, pasi ndikon në sigurinë dhe qëndrueshmërinë e rrugës. Zakonisht, pjerrësia e lejuar nuk duhet të kalojë një vlerë të caktuar, që varet nga terreni dhe lloji i përdorimit të rrugës.
3. **Kanale anësore:** Kanale të ndihmës për kullimin e ujërave janë të rëndësishme për të shmangur dëmtimet e rrugës nga uji. Parametrat për dimensionet dhe shpërndarjen e kanaleve përfshijnë lartësinë, gjerësinë dhe thellësinë e kanalit për të menaxhuar

fluksin e ujërave.

4. **Drenazhi:** Drenazhi është një pjesë esenciale për ruajtjen e qëndrueshmërisë të rrugëve dhe evitimin e përmbytjeve. Parametrat e drenazhit përcaktojnë ndarjen e ujit, vendosjen e shtresave filtrues dhe të tubave të drenazhimit për shmangien e akumulimit të ujit nën rrugë.
5. **Mbulesa rrugore:** Kjo përfshin përdorimin e materialeve që mbulojnë shtresën e sipërme të rrugës për të siguruar një sipërfaqe të sheshtë dhe të qëndrueshme. Mund të përfshijnë zhavorr, cakull, ose ndonjë tjetër material në varësi të kushteve të terrenit.
6. **Shtresa me zhavorr lumi ose cakull mali:** Materialet e përdorura për shtresat rrugore si zhavorri i lumenjve ose cakulli malor duhet të kenë dimensione të përshtatshme dhe të jenë të qëndrueshme për të ofruar një bazë të fortë dhe të mbajë rrugën të qëndrueshme edhe gjatë kushteve të motit të vështirë.
7. **Prerja e bimësisë:** Në ndërtimin e rrugëve pyjore, prerja e bimësisë mund të jetë e nevojshme për të siguruar kalueshmërinë dhe për të mbajtur sigurinë e ndërtimit të rrugës. Ky proces duhet të kryhet në mënyrë të tillë që të minimizohet ndikimi mjedisor dhe të respektohen rregullat e ruajtjes së biodiversitetit.
8. **Rregullimi i skarpatës anësore:** Për të parandaluar shembjen e dheut dhe për të ruajtur qëndrueshmërinë e rrugës, ndihmon rregullimi i skarpatave anësore (shpateve të rrugës), përdorimi i materialeve që ndihmojnë stabilizimin, dhe mbjellja e bimësisë që mund të forcojë tokën.

➤ Qëllimi i projektit

Qëllimi i projektit për rehabilitimin e rrugëve pyjore është paraqitja e gjendjes ekzistuese të tyre, dhe hartimin e projektit dhe situacionit, me qëllim përmirësimin e cilësisë, sigurinë dhe qëndrueshmërinë e infrastrukturës rrugore në zona pyjore, duke i përshtatur ato me nevojat e përdoruesve dhe kushteve të mjedisit. Ky proces është thelbësor për ruajtjen dhe zhvillimin e resurseve natyrore, ndërkohë që mundëson akses më të lehtë dhe të sigurt në zonat e thella pyjore. Qëllimi kryesor i këtij projekti janë:

- a) **Përmirësimi i kushteve të sigurisë:** Një rrugë pyjore e mirëmbajtur dhe e rehabilituar është shumë më e sigurt për përdoruesit, si për automjetet ashtu edhe për këmbësorët dhe mjetet e tjera që mund të kalojnë aty. Reduktimi i rreziqeve si rrëshqitjet e dheut, përmbytjet ose dëmtimet e rrugës është një objektivi i rëndësishëm.
- b) **Rritja e qëndrueshmërisë:** Rrugët pyjore mund të dëmtohen nga erozioni i dheut, shkarkimet e ujit ose përdorimi i tepërt. Rehabilitimi i rrugëve synon forcimin e bazës dhe strukturës së rrugës për t'i bërë ato të qëndrueshme ndaj faktorëve natyrorë.
- c) **Përmirësimi i qasjes për përdoruesit:** Rrugët pyjore shpesh përdoren për transportin e produkteve bujqësore, drurit, si dhe për kalimin e turistëve ose punonjësve të pyjeve. Rehabilitimi mundëson rritjen e efikasitetit të transportit dhe përmirësimin e kushteve të jetesës për komunitetet që varen nga këto rrugë.

- d) **Përmirësimi i menaxhimit të ujërave:** Një pjesë e rëndësishme e rehabilitimit është menaxhimi i sistemit të drenazhit dhe kullimit të ujërave. Përdorimi i kanaleve të drenazhit dhe përmirësimi i shtresave të rrugës ndihmon në shmangien e dëmtimit të rrugës nga përmytjet dhe rrëshqitjet.
- e) **Mbrojtja e mjedisit dhe biodiversitetit:** Kur realizohet rehabilitimi i rrugëve pyjore, është e rëndësishme të minimizohet ndikimi negativ në ekosistemet natyrore. Kjo mund të arrihet duke zbatuar praktika të tilla si ruajtja e bimësisë ekzistuese, përdorimi i materialeve miqësore me mjedisin dhe planifikimi i rrugës në mënyrë që të shmanget shkatërrimi i habitateve natyrore.
- f) **Përmirësimi i kushteve të transportit për menaxhimin e pyjeve:** Rehabilitimi i rrugëve pyjore ndihmon në një menaxhim më të mirë të burimeve pyjore, duke mundësuar transportin e materialeve të pyjeve në mënyrë të sigurt dhe efikase, duke kontribuar në një menaxhim të qëndrueshëm të pyjeve.
- g) **Zhvillimi ekonomik i zonave rurale:** Rrugët pyjore të reabilituara mund të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik të zonave rurale, duke përmirësuar qasjen në tregje për produktet bujqësore dhe të pyjeve, si dhe duke mundësuar zhvillimin e turizmit rural ose ekologjik.

➤ Planifikimi i Rrjetit Rrugor në Pyje

Rrugët pyjore dhe rrjetet rrugore janë ndërtuar kryesisht për të mbështetur menaxhimin e pyjeve dhe shfrytëzimin e tyre. Vitet e fundit ka pasur shumë publikime për planifikimin e kompjuterizuar të menaxhimit të pyjeve dhe të vetmen gjë të cilën e kanë të përbashkët qasjet e ndryshme, është ajo që të gjitha i shqyrtojnë alternativat e shumta dhe i shqyrtojnë kostot e ndërtimit, mirëmbajtjes dhe të transportit (Bettinger 2004; Stäckelberger 2006). Disa prej mënyrave të zgjidhjes, përdorin një qasje në mes të dy të pikave (që nënkupton lidhjen e dy pikave të destinacionit), disa të tjera e përdorin një qasje të zonave duke rritur në maksimum zonën e shërbimit, për t'iu përshtatur nevojave për menaxhim pyjor në të ardhmen.

Të gjitha zgjidhjet e mira duhet të bazohen në të dhëna të besueshme për kushtet e terrenit dhe planifikimi i rrjetit modern i rrugëve pyjore duhet të marrë në konsideratë shumë çështje. Aspektet kryesore janë theksuar në vijim:

- Vlerat ekonomike

1. Kostot e shfrytëzimit
2. Kostot e ndërtimit të rrugëve
3. Kostot e mirëmbajtjes
4. Mobilizimi i burimeve

- Vlerat mjedisore

1. Cilësia e ujit
2. Bukuritë natyror
3. Efektet në biodiversitet
4. Ndikimet ekologjike
5. Kërkesat e tokës

- Vlerat sociale

1. Rekreacioni
2. Aspektet e sigurisë (ndërhyrjet në kohë për ndihmën e parë)
3. Zhvillimi rural
4. Punësim

Disa aspekte e kanë edhe aspektin ekonomik edhe ekologjik. Për t'u analizuar cilësia e një rruge të planifikuar pyjore, duhen respektuar aspektet e ndryshme kryesore, duke shfrytëzuar mjetet e ndryshme të analizës me shumë kritere.

Për rrjetet e rrugëve pyjore në zonat kodrinore e malore, gjerësia e trasesë rrugore (përfshirë anën e gjermimit dhe anën e mbushjes), rritet me pjerrtësinë e shpatit. Figura 1 paraqet detajet e një prerjeje tërthore tipike. Në një profil tërthor me një pjerrtësi prej 100 për qind për gjermim dhe 75 për qind për mbushje.




Figura 1: Prerja tipike e tërthort

➤ Qasja në shifrat kryesore

Një përshkrim sasior dhe cilësor i një rrjeti rrugor bëhet në shumë mënyra. Për problemet e qasjes prej një rës pikë në tjetrën, distanca është variabla e vetme. Megjithatë, rrugët pyjore duhet t'i kryejnë dy funksione.

1. Funksioni i parë është ai prej një rës pikë në tjetrën për të gjitha llojet e transportimit të produkteve pyjore.
2. Funksioni i dytë është hapja e sipërfaqeve në të dy anët e rrugës për të gjitha operimet që kanë të bëjnë me menaxhimin e pyjeve, p.sh., për shfrytëzim, silvikulturë, prodhim pyjor dhe shuarje të zjarreve.

Hapësirat rrugore janë indikacioni i parë nëse rrjeti rrugor u përshtatet sistemeve menaxhuese në përdorim. Në zonat e rrafshëta, me një proporcion të madh në mes të gjatësisë së rrugës dhe numrit të kryqëzimeve, hapësira rrugore jep një indikacion të mirë të cilësisë së një rrjeti rrugor. Për zonat ku pjerrësia e terrenit është më e lartë se sa pjerrësia rrugore maksimale e lejuar, zhvillimi i një rrjeti rrugor ka nevojë për më shumë kryqëzime dhe kthesa për të siguruar qasje në të gjitha zonat përkatëse.

Sipas topografisë dhe kushteve të tokës, rrjetet rrugore tregojnë hapësira të ndryshme rrugore dhe kështu ato mund të ofrojnë vetëm informata mesatare, më pak të sakta për zonat me mundësi qasjeje.




Figura 4: Gjatësia rrugore dhe densiteti




Figura 5: Hapësira rrugore dhe ajo e qasjeje

Densiteti i rrugëve përdoret zakonisht për të përshkruar cilësinë e një rrjeti rrugor. Ai mund të llogaritet lehtë (gjatësia e rrugëve / sipërfaqja pyjore), edhe pse ai është vetëm një indikacion i dobishëm për situatën e qasjes së sipërfaqeve të mëdha në nivel rajonal dhe kombëtar. Në nivel të ndërmarrësisë, është shumë më mirë që situata e qasjes të vlerësohet me shifra të tjera. Densiteti rrugor nuk jep ndonjë informatë për mënyrën se si shpërndahet mundësia e qasjes nëpër terrene pyjore. Një rrugë afër kufijve të zonës pyjore, e cila ka vetëm një qasje të efektshme në një anë të rrugës, konsiderohet në të njëjtën mënyrë sikurse ajo rrugë në mes të pyllit e cila ka qasje dhe shfrytëzohet në të dyja anët. Një numër i madh i kthesave në formë kurbeje do të rrisë densitetin e rrugëve, mirëpo nuk do të përmirësojë situatën e qasjes në të njëjtin dimension.

Tabela 1 tregon mënyrën se si ndikon skica e planifikimit në zonën me mundësi qasjeje. Modelet (b) dhe (c) kanë të njëjtën gjatësi, hapësirë dhe densitet, mirëpo modeli (c) ka një zonë qasjeje dukshëm më të madhe. E njëjta vlen edhe për modelet (c) dhe (f). Kthesat dhe kryqëzimet në zona të pjerrëta do të duken sikurse modeli (f), derisa seksionet e rrafshëta do të duken sikur modeli (b). Këto modele të përgjithshme vetëm tregojnë që densiteti i rrugës nuk duhet të përdoret shpesh si kriteri i vetëm për vendimmarrje.

Tabela 1: Shifrat kryesore për modelin e rrjetit rrugor

		a	b	c	d	e	f
Gjatësia e rrugës	m	4 000	4 472	4 123	5 972	4 472	4 123
Densiteti i rrugës	m/ha	10.00	11.18	10.31	14.93	11.18	10.31
Hapësira rrugore	m	1 000	894	970	670	894	970
Përqindja e qasjes	%	75%	81%	64%	98%	90%	77%

➤ Konceptet e qasjes

Rrjeti rrugor i përkryer – që shmang ngatërrimin e rrugëve – do të ishte me rrugë paralele pa kryqëzime (SEGEBADEN 1964). Rrjetet e rrugëve pyjore shpesh nuk do të mund të zhvilloheshin në një model gjeometrik të caktuar të rrugëve paralele dhe/ose drejtkëndore për shkak të kushteve topografike dhe gjeologjike.

➤ Terreni i rrafshët

Për zonat ku pjerrtësia maksimale e terrenit është më e ulët se sa pjerrtësia maksimale e pranuar e rrugës, struktura rrugore mund të dizajnohet pa e marrë parasysh topografinë. Nëse kushtet e tokës e mundësojnë, një rrjet rrugor gjeometrik i rregullt, është zgjidhja më e mirë.

➤ Terreni kodrinor e malor

Për zonat ku pjerrtësia e terrenit është përgjithësisht më e lartë se sa pjerrtësia e pranueshme maksimale e rrugës, rrjeti rrugor zhvillohet në pajtim me topografinë. Ekzistojnë disa parime bazë për zhvillimin e rrjetit. Shembujt janë bazuar në SEDLAK 1985.

➤ Rrugët e luginës

Për të hapur rrugë në zonat pyjore, ndiqen rrjedha e përrrenjve përderisa pjerrtësia e tyre është brenda kufijve të kategorisë së rrugëve pyjore. Luginat anësore lidhen me anë të një lakoreje. Rruga duhet të ndërtohet brenda një distance të sigurt të përroit. Kryqëzimi i përroit si pjesë e lakut të pasëm mund të bëhet si lug, kanal nënrrugor ose urë, duke marrë parasysh një rrjedhë

të pakalueshme uji në rast të përmbytjeve. Vendi i kalimit duhet të jetë mbi pikën ku përroi anësor derdhet në përroin kryesor, për të mbajtur rrjetin rrugor funksional gjatë përmbytjeve.




Figura 6: Rruga e luginës me kryqëzim në luginën anësore

Përroi ka shpesh katarakte (Figura 7), ku pjerrësia e përroit është përtej gjerësisë së pjerrësisë rrugore. Në rastet e tilla, zgjidhje është një lakore (serpentinë) në tatëpjetë ose në një luginë anësore, për t'u kthyer afër gjirit pas kataraktit. Radhitja më e gjatë dhe lartësia mbidetare e rrugës (krahasuar me përroin), i jep asaj mundësinë që të kthehet tek lugina kryesore dhe ta përcjellë shtegun lart përderisa pjerrtësia e përroit është brenda gjerësisë së pjerrtësisë së mundshme të rrugës.




Figura 7: Rruga e luginës me lakore (serpentinë) dhe kryqëzim në luginën anësore për të kapërcyer një katarakt dhe për t'u kthyer në luginën kryesore



Figura 8: Rrugët e pjerrëta ku pjerrtësia e përroit është shumë e rrëpi

➤ Rrugët me nivel të ngritur

Sipërfaqet përgjatë përrenjve shpesh kanë terrene moçalore ose përndryshe të papërshtatshme për ndërtimin e rrugëve. Përdorimi i gjeo-tekstileve dhe masave të tjera teknike e bëjnë të mundur edhe pse të kushtueshëm, ndërtimin e rrugëve në një mjedis të tillë. Rreshtimi i rrugëve përgjatë bregut është shpesh edhe alternativa më e favorshme.




Figura 9: Rrjeti rrugor i pyjeve në kushte jostabile të tokës

➤ Rrugët e pjerrëta

Në të gjitha rastet ku pjerrtësia e përroit është shumë e madhe, rrjeti rrugor duhet të zhvillohet mbi shpat. Kjo rrugë e ndjek përroit sa më shumë që është e mundur dhe pastaj kthehet në një bërryl (Fig. 9) të shpatit. Është e rëndësishme që të zvogëlohet në minimum numri i kthesave dhe të bëhet vendosja optimale e tyre (që nënkupton vendosja në vend stabil dhe të trafshëti, shih Figurën 6 dhe 7).



Figura 10: Rruga e pjerrët

Rrugët pa krye dhe ato për tërheqje (Figura 10) shpesh lidhen me kthesën për të zgjatur zonën e qasjes.




Figura 11: Rruga e pjerrët me kryqëzime për të zhvilluar rrjetin

Në rajonet kodrinore e malore, veçoritë e tokës shpesh tregojnë modele jo të favorshme për

menaxhim, p.sh. rrip i ngushtë pas pjerrtësisë së shpatit, me tokë bujqësore në fund të luginës, duke vazhduar me zonë pyjore në shpat dhe në maje të tij me kullota. Duke qenë tatëpjetat e ndara me anë të këtyre kufijve pronësorë, një numër lakoreje (serpentinash) duke filluar nga kullota kryesore, sigurojnë qasje te grumbujt pyjorë.

Kjo krijon shumë kthesa në një hapësirë të ngushtë. Shfrytëzimi jo i duhur i peizazhit dhe rreziku i madh i erozionit të tokës me anë të rendit të shpeshtë të kthesave të cilat kanë ndikim të madh në stabilitetin e shpatit, janë mangësi e këtij lloji të rrjetit rrugor pyjor. Shtytësi kryesor për struktura të tilla është krijimi i rrjetit rrugor në pronën e titullarit.

Figura 11 e tregon këtë efekt, i cili do të mund të shmangej lehtë me anë të zgjidhjeve integrale të prezantuara në Figurën 12. Për të mbajtur numrin e kthesave në minimum, pronarët e parcelave të vogla duhet të bashkëpunojnë. Situata e rripave të ngushtë, jo të favorshëm është paraqitur po ashtu në Figurën 11.




Figura 12: Shembull i keq i zhvillimit të rrugëve të shpatit ndaras




Figura 13: Shembull i mirë i hapjes së një shpati me distanca të mëdha midis kthesave

➤ Elementet e rrugëve

Për tatëpjetën e pjerrët më pak se 50%, segmentet rrugore lineare kanë prirje që të mos kenë probleme stabiliteti. Përfundimi i vetëm është kur kryqëzohet një tatëpjetë strukturalisht jo stabile, rreziku për dështim është më i madh; në përgjithësi, nëse një terren është i pjerrët për nga natyra, kjo është shenjë e stabilitetit; nëse një terren është i rrafshët për nga natyra, ky zakonisht është rezultat i lëvizjeve të masës).

Elementet më kritike të rrjeteve të rrugëve pyjore janë kthesat, vendkalimet në përrenj dhe deri në një shkallë edhe kanalet.

Ato janë më të shtrenjta për t'u ndërtuar dhe ndikimi mjedisor është më i ashpër. Kthesat dhe vendkalimet në përrenj kanë një ndikim të madh në tokë dhe hidrologjinë e tatëpjetës.

Prandaj, përzgjedhja e vendosjes së këtyre elementeve është prioriteti i parë gjatë zhvillimit të një rrjeti rrugor.

➤ **Kthesat**

Përzgjedhja e vendeve të favorshme për kthesa është pjesa më e rëndësishme e planifikimit të përgjithshëm. Në hapin e parë, identifikohen zonat stabile me pjerrtësi të cekët. Këto zona që duhet të qasen në çdo rast quhen pika kardinale.

➤ **Vendkalimet në përrenj**

Gjatë dizajnit të vendkalimit të përroit, lugut, kanalit nëntokësor ose urave, merret parasysh funksionaliteti gjatë vërshimeve. Vëllimi i ujit që kalon nëpër seksione është produkti i sipërfaqes tërthore të vendkalimit dhe shpejtësisë së rrjedhës. Terrenet e pjerrëta stabile dhe pjesët e rrëpirëta përgjatë një përroi me rrjedhë të shpejtë janë vendkryqëzime të favorshme. Duke shmangur zonat ku përroi rrjedh ngadalë dhe vendi i shtratit të përroit mund të ndryshojë gjatë viteve. Kapaciteti i vendkryqëzimeve të tilla të favorshme është më i madh për shkak të shpejtësisë më të madhe të rrjedhës. Erozioni në fund të përroit mund të rrezikojë themelet e infrastrukturës dhe kjo shmanget me anë të masave të përforsimit.

➤ **Struktura e sipërme e rrugës**

Rrugët pyjore shpesh ndërtohen si rrugë të pashtruara. Kjo mund të jetë funksionale në kushte perfekte (tokë e terur me kapacitet të lartë për bartje) dhe për ndërhyrje urgjente (fatkeqësitë në përgjithësi), mirëpo ato nuk i plotësojnë kurrë kërkesat e një rruge pyjore. Nëse rrugët e tilla të përkohshme nuk përmirësohen, ato nuk do të kontribuojnë në një rrjet rrugor pyjor funksional.

Mbi çdo nënshtresë, një rrugë pyjore ka nevojë për një shtresë të sipërme (RYAN et al. 2004). Sipërfaqja e sipërme e rrugës duhet të mbrojë shtegun e rrugës, nëse është e nevojshme edhe të forcojë formimin dhe të sigurojë një sipërfaqe të përshtatshme për automjete. Kjo strukturë mund të jetë e fortë, e butë, duke përdorur zhavorr. Për rrugët pyjore, zhavorri është forma më e zakonshme e shtresës së sipërme. Nganjëherë materiali mund të grumbullohet nga gurthyesit lokalë që ndodhen përgjatë rrugës. Në çdo rast, materiali duhet të vendoset atëherë kur shtegu është i thate. Për rrugët pyjore, një shtresë zhavorri prej 20 cm, me një trashësi të grimcave prej 0 deri 60 mm do të funksiononte në të shumtën e rasteve.

➤ **Menaxhimi i ujit**

Prioriteti më i lartë është që shtegu rrugor të mbahet i terur. Kanali anësor duhet të mbledhë të gjitha të reshurat dhe t'i drejtojë teposhtë. Kjo mund të bëhet me anë të hendeqeve ose kanaleve.

Aty ku nënshtresa ka përmbajtje të lartë të lagështisë, drenazhimi me përdorimin e gurëve të mëdhenj mund të ndihmojë që shtegu rrugor të mbahet i terur.

Mirëmbajtja e rregullt dhe shfrytëzimi i duhur i rrugëve pyjore janë të rëndësishme si për menaxhimin e pyjeve ashtu edhe për përdorimin shumë qëllimor të pyjeve. Përveç kësaj, në shumë raste, rrugët pyjore planifikohen dhe ndërtohen edhe për qëllime të tjera, si për zhvillimin e fshatrave, zonave rurale, turizmit dhe rekreacionit.

Aktivitetet e mirëmbajtjes kanë për qëllim mbrojtjen e investimit kapital fillestar në ndërtimin e rrugëve dhe aty ku është e nevojshme për të bërë përmirësime lokale me qëllim të rritjes së

efikasitetit të përdorimit (FANNIN, LORBACH 2007) Mirëmbajtja është po ashtu e nevojshme për siguri të vazhdueshme të përdoruesve dhe për të zvogëluar kostot operative të automjeteve.

➤ Mirëmbajtja

Mirëmbajtja e rregullt dhe shfrytëzimi i duhur i rrugëve pyjore janë të rëndësishme si për menaxhimin e pyjeve ashtu edhe për përdorimin shumë-qëllimor të pyjeve. Përveç kësaj, në shumë raste, rrugët pyjore planifikohen dhe ndërtohen edhe për qëllime të tjera, si për zhvillimin e fshatrave, zonave rurale, turizmit dhe rekreacionit, mbrojtjes nga zjarret etj.

Aktivitetet e mirëmbajtjes kanë për qëllim mbrojtjen e investimit kapital fillestar në ndërtimin e rrugëve dhe aty ku është e nevojshme për të bërë përmirësime lokale me qëllim të rritjes së efikasitetit të përdorimit (FANNIN, LORBACH 2007). Mirëmbajtja është po ashtu e nevojshme për siguri të vazhdueshme të përdoruesve dhe për të zvogëluar kostot operative të automjeteve



➤ Qëllimet e mirëmbajtjes së rrugëve pyjore

Mirëmbajtja e rrugëve pyjore ka disa qëllime:

1. Të mbajë rrugët pyjore në kushte të mira sa më shumë që është e mundur;
2. Të mbrojë përdoruesit prej aksidenteve dhe rreziqeve;
3. Të zvogëlojë dëmet në automjete.
4. Shërbejnë si koridore zjarri,
5. Etj.

Nëse rrugët pyjore nuk mirëmbahen rregullisht dhe ashtu si duhet, ato e humbin funksionalitetin e vet dhe në rastin më të keq edhe mund të shemben. Nëse ndodh kjo, kostoja e mirëmbajtjes dhe e riparimit rritet, bashkë me kostot e transportimit të drurit dhe operacioneve pyjore. (BEGUŠ, 2013).

➤ Llojet e mirëmbajtjes

Në përgjithësi, mund të flasim për dy regjime kryesore të mirëmbajtjes; përkatësisht për mirëmbajtjen parandaluese dhe për atë sipas nevojës.

- Në kuadër të regjimit të mirëmbajtjes parandaluese rrugët pyjore mirëmbahen në mënyrë të vazhdueshme që nga dita e parë, për të ndihmuar parandalimin e ndonjë

defekti të madh dhe dëmtimin e rrugës së shtruar (LARCOMBE, 1999). Kjo qasje quhet mirëmbajtje parandaluese, e cila e zgjat jetëgjatësinë e rrugës.

- Mirëmbajtja sipas nevojës ose mirëmbajtja jo e rregullt korrigjon çdo defekt që mund të paraqitet. Kostot e kësaj qasjeje janë më të ulëta, mirëpo rruga mund të kërkojë riaftësim më të hershëm.

Regjimi i mirëmbajtjes do të përcaktohet sipas rëndësisë së rrugës,

- rrugët kryesore do të kërkojnë mirëmbajtje parandaluese
- ndërsa rrugët me ngarkesa më të ulëta mund të mirëmbahen sipas kërkesës.

Njihën disa aspekte të mirëmbajtjes së rrugëve pyjore (DOBRE, 1994):

- Aspekti kohor
 - Për çdo vit në mënyrë
 - periodike (nga 5-10 vjet, ri-shtrimi i rrugës, rindërtimi)
- Aspekti ekonomik
 - Mirëmbajtja e rregullt (fondet vjetore)
 - investimi (fondet investive)
- Aspekti teknik
 - Riparimi i dëmeve të vogla në rrugët për bartje
 - Rindërtimi (ri-shtrimi i shtresës së sipërme rrugore)
- Lidhja midis aspekteve të ndryshme çdo vit = e rregullt = riparuese në mënyrë periodike = investuese = rindërtim
- Mirëmbajtja me anë të metodës së punës
 - Në mënyrë manuale
 - Në mënyrë mekanike
 - Kombinimi i të dyjave

➤ Dallimi në mes të riparimit, mirëmbajtjes dhe përmirësimit

Përmirësimi i rrugës ka të bëjë me rivendosjen e objekteve rrugore në gjendjen e tyre të mëparshme. Nganjëherë kjo merr formën e mirëmbajtjes dhe nganjëherë përbën edhe rindërtimin e rrugëve pyjore. Riparimet dhe mirëmbajtja e rrugëve pyjore janë operacione të ndara (RYAN et al., 2004).

Mirëmbajtja ka të bëjë me mbajtjen e rrugëve në gjendje të përshtatshme për përdorim. Ajo duhet të bëhet vazhdimisht dhe të financohet nga burimet strukturore.

➤ Parimet e mirëmbajtjes së rrugëve pyjore

Mirëmbajtja e rrugëve pyjore bëhen në përputhshmëri me parimet e nevojave për menaxhimin e pyjeve, mbrojtjen e natyrës, kërkesat teknike dhe nevojat (jo-pyjore) e shfrytëzuesve të tjerë, në një mënyrë që nuk:

- Rrezikon burimet dhe rrjedhën e ujit;
- Shkakton erozion;
- Dëmtton ekosistemet pyjore;
- Kërcënon habitatet e llojeve të rralla e të mbrojtura të bimëve dhe kafshëve;
- Parandalon rrjedhën normale të ujit nga rrëketë/përrenjtë;
- Destabilizon dheun dhe rrit rrezikun e rrëshqitjes së tokës;
- Kërcënon funksionet e pyjeve.

Sipas standardeve profesionale, mirëmbajtja e rrugëve pyjore duhet të përfshijë:

- Menaxhimin e ujit/drenazhimit;
- Riparimin e sipërfaqes dhe nënshtresës së rrugëve pyjore;
- Në mënyrë manuale, të mekanizuar ose të kombinuar;
- Riparimin e mureve mbajtëse;
- Pastrimin e llumit të argjilës dhe materialeve të tjera;

Më së shumti në lidhje me rrugët pyjore dhe rrugët për tërheqje, kryesisht për shkak se këto të fundit nuk janë dizajnuar ose mirëmbajtur si duhet (kanale të tërthorta) ose gjatë dhe pas kryerjes së operacioneve pyjore;

- Mirëmbajtjes gjatë dimrit (pastrimi i borës dhe rërës);
- Riaftësimi i rrëshqitjes së tokës etj.



Fotografia 2: Kur përfundohen operacionet pyjore, mbetjet duhet të pastrohen (Fotografia: Juri Begu)

➤ Arsyet e degradimit të rrugëve pyjore

- Degradimi i rrugëve pyjore shkaktohet nga:
 - Planifikimi dhe ndërtimi jo i duhur i rrugëve pyjore;
 - Shfrytëzimi jo i përshtatshëm
 - Shkaqet e mjedisit jetësor;
 - Erozioni, rrëshqitjet
 - Reshjet
 - Etj
- Planifikimi dhe mirëmbajtja jo e duhur:

Edhe kur planifikohet hapja e zonave pyjore, në fazën e planifikimit dhe në fazën e ndërtimit është e nevojshme të merret parasysh mirëmbajtja e rrugëve pyjore. Planifikimi dhe ndërtimi jo i duhur shpërndan në kosto më të madhe të mirëmbajtjes (më shpesh dhe mirëmbajtje të vështirë).



Fotografia 3: Një lug i bërë prej betoni ose guri duhet të parashihet në fazën e planifikimit për kallimino një përroi sikurse ky që është paraqitur më sipër (Fotografia: Juri Begu)

Ndikimet në statikën e rrugës për bartje paraqiten atëherë kur masa e automjetit është më e madhe se sa kapaciteti bartës i asaj strukture (rruge). Kapaciteti i bartjes zvogëlohet për shkak të rrallimit të shtresës së sipërme ose për shkak të ndikimit të ujit në shtresën e sipërme ose të poshtme (zbutja), e cila paraqitet pas reshjeve të gjata, shkrirjes dhe ndikimit të ujërave tokësore etj. Pasojat më të zakonshme të ndikimeve dinamike janë vruga e rrotave.

➤ **Shkaktarët mjedisor**

- Uji

Menaxhimi i ujit është një prej elementeve kryesore të ndërtimit dhe mirëmbajtjes së rrugëve. Uji vjen në shumë mënyra dhe forma p.sh., uji nga reshjet, uji rrjedhës, bora dhe akulli. Efektet e kundërta të ujit e përfshijnë:

- Uji nga reshjet (erozioni i rrugës për bartje);
 - Uji i lëngshëm (erozioni i rrugës për bartje, depozitimet, ...);
 - Ngrirja (zvogëlon kapacitetin e bartjes dhe deformimin e rrugës për bartje);
 - Ujërat nëntokësore;
 - Bora dhe akulli.
- Pasojat e ndikimit të ujit ndaj rrugëve pyjore janë:
 - Shpëlarja e grimcave të imëta që janë të rëndësishme për lidhjen e shtresës së sipërme të rrugës;
 - Erozioni i rrugës për bartje;
 - Thellimi i gropave;
 - Zbutja e rrugës për bartje;
 - Depozitimi i materialit;
 - Shkarja e tokës;
 - Dëmtimi i argjinaturës.
 - Etj.

Uji po ashtu mund të shkaktojë rrëshqitjen e tokës dhe dëmtime në anën e gërmuar ose në anën e mbushur të rrugës.

➤ **Ndikimet tjera prej mjedisit**

Vegjetacioni (i tej-rritur në rrugët pyjore) mund të paraqesë pengesë për drenazhim të duhur. Rrënjët në shtresën e sipërme të rrugës e shtendosin strukturën e saj dhe lejojnë që uji ta zbusë strukturën e rrugës dhe rrugën për bartje.

Pastrimi i pamjaftueshëm i kanaleve nënrrugore mund të rezultojë në vegjetacion dhe rrënjë, duke kontribuar kështu në drenazhim jo të plotë. Pastrimi jo i duhur i vegjetacionit të anëve përgjatë rrugës – veçanërisht në anën e mbushur – shkakton probleme në realizimin e mirëmbajtjes (në rrafshim).



Fotografia 4: Anësoret rrugore me pastrim jo të duhur të vegjetacionit (Fotografia: Juri Begu)

Stuhia (akulli, bora, era, reshjet) në fonna të ndryshme dhe kombinime të tyre mund të shkaktojnë dëmtime të ndryshme të rrugëve pyjore, duke zvogëluar kështu dobishmërinë e tyre të përgjithshme.

- Dëmtimi më i shpeshtë përfshin:

Erozionin e sipërfaqes rrugore;

Dëmtimet e sistemeve të drenazhimit;

Rrugët e bllokuara nga rënia ose thyerja e drunjve.



Fotografia 5: Reshjet e mëdha, përdorimi jo i duhur dhe mirëmbajtja e pamjaftueshme/jo e duhur e shkaktojnë erozionin e madh të rrugës për bartje të një rruge pyjore (Fotografia: Juri Begu)

➤ Elementet e mirëmbajtjes

Elementet kryesore të mirëmbajtjes janë :

- Drenazhimi i ujit
- Sipërfaqja/shtresa e sipërme e rrugës
- Baza e rrugës/struktura
- Kontrolli i vegjetacionit
- Mirëmbajtja e sistemeve të drenazhimit

➤ Drenazhimi i ujit

- Drenazhimi i referohet bllokimit, grumbullimit dhe largimit të ujit si nga shtresa e rrugës ashtu edhe nga shtegu në në anën bregore të një rruge. Si i tillë, termi drenazhim u referohet fillimisht metodave për kontrollimin e çdo uji sipërfaqësor dhe uji nëntokësor që ka ndikim në një rrugë (FANNIN, 2007). Mirëmbajtja e sistemit të drenazhimit është aspekti më i rëndësishëm i mirëmbajtjes rrugore.
- Dallohet drenazhimi i shtresës rrugore dhe drenazhimi i shtigjeve të rrugëve pyjore. Drenazhimi i shtresës rrugore arrihet me pjerrësinë e anëve të rrugës për bartje dhe kanaleve radiale të formave të ndryshme. Drenazhimi i shtigjeve të rrugëve pyjore bëhen me kanale anësore, kanale nëntokësore, ura irlandeze, lugje ujëmbledhëse dhe ura.

Elementet e drenazhimit që përdoren në rrugë pyjore e përfshijnë: përmirësimin e sipërfaqes, kanalet kulluese, kanalet nëntokësore/urat dhe lugjet ujëmbledhëse. Sigurimi i drenazhimit duhet të përfshijë (FANNIN, 2007):

- Një pjerrtësi e tërthortë mbi sipërfaqen e shtresës së rrugës, me shkallëzim të mjaftueshëm, i cili e drejton çdo ujë sipërfaqësor drejt kanalit;
- Një kanal me kapacitet të duhur për të përballuar rrjedhën;
- Një kanal nëntokësor ose urë me kapacitet të duhur për shkarkim, i cili duhet të vendoset në një nivel që e mban rrjedhën mjaftueshëm;
- Një lug ujëmbledhës që siguron qasje të lehtë për kalim.



Fotografia 6: Një lug ujëmbledhës prej betoni mardëson kalimin e përroit përmbi rrugë
(Fotografia: Juri Begaj)

Gabimet e zakonshme në drenazhim e përfshijnë:

- një rrafshim të dobët në sipërfaqen e shtresës rrugore, që shpie deri në formimin e pellgjeve nga uji sipërfaqësor;
- mbi terrene të rrëpirëta në kombinim me vragat ekzistuese të rrotave që rezultojnë në erozion të sipërfaqes;
- një kanal anësor me konfigurim jo të duhur mund ta ekspozojë strukturën rrugore ndaj futjes së ujit;
- shumica e dështimeve të vendkalimeve paraqiten nga kapaciteti jo i duhur dhe ndërtimi jo i duhur.



Fotografia 7: Erozioni sipërfaqësor në terren të rrëpirët (Fotografia: Jari Beguš)

➤ Mirëmbajtja e sistemeve të drenazhimit

- Rrafshimi i sipërfaqes rrugore

Me rrafshimin e shtresës së sipërfaqes, profili i rrugëve pyjore formësohet për të përmirësuar rrjedhën në drejtim të tërthortë. Ajo mund të drejtohet në njërin anë drejt kanalit ose mund të ketë një profil "kurore", i cili e drejton rrjedhën e sipërfaqes në të dy anët e rrugës.

Për sipërfaqe rrugore rekomandohet përdorimi i zhavorrit nëse kjo është mundshme dhe financiarisht e realizueshme. Grimcat e zhavorrit kanë kënde të mprehta, të cilat mundësojnë kontakt të mirë mes tyre.

Zhavorri duhet të përmbajë një përqindje të caktuar të grimcave të argjilës/baltës dhe duhet të jetë i lagësht, që është më mirë se sa shumë i terur ose shumë i lagësht, në mënyrë që të mundësojë ngjeshjen e mirë.

Mënyra më e mirë e rrafshimit është përdorimi i rrafshuesve. Pas rrafshimit, sipërfaqja duhet të kompaktësohet. Shmangiuni krijimit të një shtrati me material anash rrugës për bartje, i cili mund të krijojë barrierë për drenazhim anësor nga uji sipërfaqësor.

Vegjetacioni i qartë nga rruga për të mundësuar rrjedhë të lehtë dhe efikase të ujit sipërfaqësor. Vëmendje e veçantë duhet t'u kushtohet drunjve që ndodhen anash rrugës, sepse ata mund të rriten tepër, saqë të shkaktojnë probleme lidhur me rrafshimin.



Fotografia 8: Shmangni krijimin e një strati me material anash rrugës për burtje (Fotografia: Juri Begu)



Fotografia 9: Vegetacioni në anën e majtë të fotografisë e hën të pamundur rrafshinin normal

➤ Konfigurimi i kanalit kullues

Një kanal kullues duhet të ketë formë të njëtrajtshme, pa pengesa që do të mund të pengonin ose t'ia ndërrojnë drejtimin rrjedhës së ujit (mbetjet e drurit, asortimentet e drurit, gurët, shkëmbinjte...).

Këto pengesa mund të shpijnë në erozionin e bazës së tokës ose sipërfaqes së tokës. Qëllimi i kanalit kullues nuk është vetëm transportimi i ujit, por është edhe ndërprerja e burimeve dhe ulja e shtresës ujore. Kanali kullues anësor ka dallim nga kanali kullues kryqëzues.



Fotografia 10: Pengesat në kanal (Fotografia: Juri Begu)

Kanalet anësore duhet të kenë një shkallë gjatësore prej 2 për qind ose më shumë, për të siguruar që rrjedha nuk ka pëllg të padëshirueshëm në kanal. Për profilin e tërthortë të kanalit duhet të përdoret një formë e gjerë trekëndëshi, meqë ajo shpie në kompromisin e kapacitetit të rrjedhës dhe lehtësisë së mirëmbajtjes. Forma "U" nuk duhet të përdoret meqë ajo ka tendencë të bëhet pëllg dhe kjo mund të gërmojë skajet e anës së gërmimit ose krahut të rrugës. Pjesa e poshtme e kanalit duhet të vendoset në nivelin e nënshtresës për të parandaluar hyrjen e padëshirueshme të ujit në drejtim të bazës. Kanalet nën- tokësore të tërthorta duhet të vendosen në vende kritike në kanal (në një nivel të ulët në drejtimin e rrugës, para seksionit të rritjes së tatëpjetës). Nëse një kanal ndodhet në një tokë shumë gërryese, ajo duhet të stabilizohet me gurë dhe dru. Një lloj shumë i zakonshëm i kanalit është kanali për drenazhim, i cili zakonisht formësohet në kombinim me një profil kurorë të rrugës. Ato ndërtohen në tokë të depërtueshme dhe në zona ku nuk priten sasi të mëdha të ujit



Fotografia 11: Kanali i tërthortë (Fotografia: Juri Beguš)

